



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare
www.legjislacioni.gov.al

Nr.90

Datë 16 qershor 2014

P Ë R M B A J T J A

Urdhër i ILDKPKI
nr. 996, datë 16.6.2014

Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave private

Faqe

3599

URDHËR
Nr. 996, datë 16.6.2014

**PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË
DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATE**

Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 7.4.2005, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularëve sipas llojeve të deklarimit të interesave private, të përcaktuara në nenet 5/1, 7, 7/1 dhe 9, të ligjit nr. 9049, datë 7.4.2005, të ndryshuar, bashkëlidhur këtij urdhri:

- Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës.

- Deklaratë e interesave private periodik vjetor.

- Deklaratë e interesave private pas largimit nga funksioni.

- Deklaratë e interesave private me kërkesë.

2. Urdhri nr. 620, datë 22.11.2012, “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private” i inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM I INSPEKTORATIT
TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Shkëlqim Ganaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", tel: 0800 9999, fax: 042 228-516, website: www.hidaa.gov.al, e-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	
---------------------------------------	--

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklaram të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014.

AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Emri	Atësia	Mbiemri
Funksioni		
Institucioni dhe adresa		
Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës	

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë " i ndryshuar,

AUTORIZOJ:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga autoriteti përgjegjës - inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i zyrtarit

**TË DHËNA PERSONALE TË
SUBJEKTIT DHE
PERSONAVE TË LIDHUR**

PËRBËRJA FAMILJARE E ZYRTARIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen civile:
(njësia administrative nr. , rruga, pallati nr. , bashki/komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër,
adresa e plotë ku banoni:

Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në funksion të kufizimit të interesave privatë për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë tringut familjar) dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja civile
					Babai i deklaruesit	
					Nëna e deklaruesit	
					Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					I biri/e bija e ndarë nga prindërit	
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e fillimit të detyrës, sipas germave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” * të nenit 4 dhe nenit 4/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve, shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

* Neni 4, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

* Neni 4/1, zyrtari që plotëson deklarin për herë të parë nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Objekti i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e fillimit të detyrës, sipas germave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” të nenit 4 dhe nenit 4/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

* Neni 4, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

* Neni 4/1, zyrtari që plotëson deklarin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milionë lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milionë lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklarës së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

Objekti i deklarimit: Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të zyrtarit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 janar, deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit në detyrë.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të punës prej zyrtarit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të punës (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhëna konfidenciale në lidhje me: pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interes.	Nr. i regjistrit publik, Nr. i kontratës noteriale, data/muaji/viti

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklaram:

Emër, atësi, mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave private, vendndodhja e tyre

Emri, mbiemri,
Nënshkrimi i zyrtarit

Telefon privat e celular

Telefon zyre, faks, e-mail

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", tel: 0800 9999, fax: 042 228-516, website: www.hidaa.gov.al, e-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi
në ILDKPKI

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklaram në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

AUTORIZIM PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Në bazë të nenit 9/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar,

AUTORIZOJ:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga autoriteti përgjegjës - inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/sja _____, bashkëshorti/ja ☐
 emër, atësi, mbiemër fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
 fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐
 bashkëjetuesi/ja ☐

i/e subjektit _____
emër, atësi, mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim. ☐

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim. ☐

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

**DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

*Objekti i deklarimit (neni 4, germet "a", "b", "c", "ç", "d", i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* Neni 4/1, zyrtari që plotëson deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar mbi shumë 1.5 (një presje pesë) milionë lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milionë lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklarats së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

- Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data 1 janar, deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit të zytarit.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 janari deri datën e fillimit në detyrë.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të punës të zytarit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr. 11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe koston mujor, si dhe dokumentat shoqërues që disponohen.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të punës. (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhëna konfidenciale në lidhje me: pasuri private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrime financiare, burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat me të cilët keni marrëdhënie interesi.	Nr. i regjistrit publik, Nr. i kontratës noteriale, data/muaji/viti

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

Nr. personal i personit të lidhur

Adresa

Telefon privat e celular

Telefon zyre, faks, e-mail

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në dy ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Deklarimi i interesave private nga zyrtari

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës” duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit nga funksioni i mëparshëm.
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), bashkëjetuesit/es, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
- Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, jo më vonë se 30 ditë, nga data e fillimit të detyrës.

Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga pjesëtarë të familjes (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- Subjekti/personi i lidhur me zyrtarin, *(bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore)* i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur, është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, AUTORIZIMI ku deklarohet nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

Kujdes! Të gjithë zyrtarët dhe personat e lidhur me ta (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve *cash* mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar.
- Për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi dënohet me gjobë nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kujdes! Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen nga deklaruesi, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me “Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit 042 259 461 Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Tel: 0800 9999, Fax: 042 228-516, website: www.hidaa.gov.al, e-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	
---------------------------------------	--

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE
PERIODIK / VJETOR

Plotësohet nga zyrtari që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006 ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014.

AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE

Emri	Atësia	Mbiemri
Funksioni		
Institucioni dhe adresa		
Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës	

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar,

AUTORIZOJ:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga autoriteti përgjegjës - inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i zyrtarit

**TË DHËNA PERSONALE
TË SUBJEKTIT DHE
PERSONAVE TË LIDHUR**

PËRBËRJA FAMILJARE E ZYRTARIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. personal	Lidhja me deklарuesin	Gjendja civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen civile:
(njësia administrative nr. , rruga, pallati nr., bashki/komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër,
adresa e plotë ku banoni:

Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në funksion të kufizimit të interesave private për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trugut familjar) dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr. personal	Lidhja me deklарuesin	Gjendja civile
					Babai i deklарuesit	
					Nëna e deklарuesit	
					Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					I biri/e bija e ndarë nga prindërit	
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

**NDRYSHIMET E PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

* **Objekti i deklarimit** (neni 4, gjerat "a", "b", "c", "ç", "d", i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET
NË VEPRIMTARI
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura nga zyrtari gjatë vitit të deklarimit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dDhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valute të huaj (me shifra dhe me fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i zyrtarit

--

TË DHËNA KONFIDENCIALE

DHURATA DHE TRAJTIME PREFERENCIALE

Përshkruani hollësisht llojin e dhuratës në vlerën mbi 10000 (dhjetë mijë lekë), si dhe trajtime preferenciale, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit	Identiteti i personit fizik ose juridik dhe lidhja e tij me zyrtarin	Vlera e dhuratës /trajtimit preferencial në lekë ose valutë (me shifra dhe me fjalë)

Përshkruani të dhënat KONFIDENCIALE që kanë lidhje me; pasuritë private të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, detyrimet financiare, identitetin e personit juridik ose fizik, huadhënës a huamarrës, emërtesën e institucionit publik ose privat, me të cilët keni marrëdhënie interesi	Nr. i regjistrat publik, Nr. i kontratës noteriale, data/muaji/viti

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklarim:

Emër, atësi, mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave private, vendndodhja e tyre

Emri, mbiemri,
Nënshkrimi i zyrtarit

Telefon privat e celular

Telefon zyre, faks, e-mail

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm,
vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.*

Adresa: Rr. "Reshit Collaku", tel: 0800 9999, fax: 042 228-516, website: www.hidaa.gov.al, e-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi
në ILDKPKI

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga autoriteti përgjegjës - inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

i/e Subjektit	Emër, atësi, mbiemër
---------------	----------------------

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

**NDRYSHIMET E PASURIVE
DHE BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të viti të deklarimit.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

*Objekti i deklarimit (neni 4, germet “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË
VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër, për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

**DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit të deklarimit..
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr. 11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i personit të lidhur

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

TË DHËNA KONFIDENCIALE

